

REPUBLIKA E KOSOVËS - Vlada e Kosovës MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Data: Datum: Date:
5 2	103 21.01.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovaciju / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 21.01.2022
 Nr. 5-103

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, neni 14 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/I-037 si dhe në bazë të neneve 5,6,7,8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të nenit 10 të udhëzimit administrativ (QRK) nr.03/2013 për Standardet e hartimit të akteve normative dhe në bazë të kërkesës nr. 1286 të datës 29.07.2021 për Licencim Institucional si dhe kërkesës nr. 3141 të datës 02.12.2021 për Licencim të programit sipas vendimit të AKA të datës 28/10/2021 Ref. 3475.21, vendimit 12/08/21 Ref. 3035/21, komisioni në fjalë merr këtë:

V E N D I M

Për plotësim dhe ndryshim të vendimit nr. 5-1286 i datës 31.08.2021

1. Plotësohet dhe ndryshohet pika 1 e vendimit nr. 5-1286 i datës 31.08.2021 për Akademinë "Tempulli", si në vijim:
 - 1.1. Akademia "Tempulli" licencohet për periudhën trevjeçare nga data 30.09.2021 deri me 30.09.2024, sipas vendimit të AKA, nr. 2806/21 e datës 19.07.2021;
 - 1.2. Licencohen programet e studimit sipas këtyre dy vendimeve të AKA:

Vendimi nr. 3475/21 i datës 28.10.2021 për programet studimore:

 - Programi BSC Inxhinieria e transportit dhe Infrastruktura, specializimet: Inxhinieria e trafikut dhe transportit, Inxhinieria e Infrastrukturës (rrugë, hekurudhë, hidrologji) ;
 - Programi MSC Inxhinieria e trafikut dhe siguria rrugore, specializimet: Inxhinieria e trafikut dhe transportit, Siguria në rrugë dhe menaxhimi i aksidenteve;

1.3. Si dhe vendimit nr. 3035/21 i datës 12.08.2021 për programin studimor.

- Programi BA, Sigurimet dhe menaxhimi i dëmeve nga aksidentet, specializimet: Sistemet e sigurimeve, Vlerësues të Dëmeve, Logjistikë dhe Shpedicion.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në mbështetje të dispozitave ligjore të shënuara më lartë, komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL-ve i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, bazuar në kërkesën nr. 1289 datë: 29.07.2021 e parashtruar nga Akademia Tempulli për Licencim Institucional, komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit ka nxjerrë vendim me nr. 5-1286 datë: 31.08.2021, ku e ka licencuar institucionin në fjalë për periudhën trevjeçare, 30.09.2021 deri më 30.09.2024, duke u bazuar në vendimin e AKA-së nr. 2806/21, datë: 19.07.2021.

Bazuar në kërkesën e Akademisë "Tempulli" me nr. 3141 date 02.12.2021 të plotësuar me vendimet e AKA, vendimi nr. 3035/21 i datës 12.08.2021 dhe vendimi, nr. 3475/21 i datës 28.10.2021 për programet e akredituara të studimit, komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike : Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
2. Arkivit të MASHTI;
3. Parashtruesit të kërkesës;
4. DALSHT;
5. DNJBIA;
6. Inspektoratit të Arsimit, MASHTI

Burim Gashi

Kryetar i komisionit për Licencim

